

# RRJETI PËR ZHVILLIM RURAL I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

## e-buletini

# nr.01

shtator 2011



### PUBLIKON

Rrjeti për zhvillim rural i  
Republikës së Maqedonisë  
www.ruralnet.mk  
email: info@ruralnet.mk

“Orce Nikolov”

188-1/8 1000 Skopje  
R. e Maqedonisë  
T: +389 (2) 3075 506  
F: +389 (2) 3075 503

### Të nderuar,

Para jush është buletini i parë elektronik i Rrjetit për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë – RZR i RM-së, i cili në çdo tre muaj do të do të transmetojë informata të ndryshme për aktivitetet, evenimentet, projektet, realizimet dhe publikimet e lidhura me zhvillimin rural në Republikën e Maqedonisë, të cilat do të jenë në

interes të anëtarëve të RZR të RM-së dhe opinionit më të gjerë. Buletini gjithashtu do të ndjek informatat më të reja lidhur me dispozitat ligjore si dhe mundësitë për financim në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Të njëjtat informata do të shpërndajë edhe në mënyrë elektronike para anëtarëve të RZR të RM-së dhe gjithë aktorëve relevant (Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujit, Agjencia

për Nxitjen e Zhvillimit të Bujqësisë në Republikën e Maqedonisë (ANZHB), Agjencia për Mbështetje Financiare në Bujqësi dhe Zhvillimin Rural (AMFBZR), Federata e Fermerëve e Republikës së Maqedonisë (FFRM) si dhe subjekte dhe individë tjerë që kanë shprehur interes për të marrë informatat. Njëherë, gjitha këto do të vendosen në ueb faqen e rrjetit.

Në këtë  
numër:

## 1. Aktivitete të shoqatave – anëtare të RZR të RM-së

Aktivitete të ART POINT  
Aktivitete të PREDA PLUS  
Aktivitete të QENDRËS PËR ZHVILLIM LOKAL – GJEVGJELI

## 2. Prezantimi i Rrjetit për Zhvillim Rural nga Suedia

## 3. Aktivitete të rëndësishme të RZR të RM-së për vitin 2011

## 4. Ardhmëria e LEADER

## 5. LEADER në Evropë



### EKSKLUZIVISHT NË SLLOESHTICË!

**Gruaja e parë skulptor nga Tunizia - Nazhet Gerisi (Najet Gherissi), mysafir në punëtorinë artistike e ART POINT - GUMNO**

Fëmijët nga Slloeshtica dhe mysafirja nga punëtorija artistike e ART POINT – GUMNO nga Tunizia, Nazhet Gerisi (Najet Gherissi) ndihmojnë “Bella Reka” të mbrojtë peshqit



## 1. AKTIVITETE TË SHOQATAVE – ANËTARE TË RZR TË RM-SË

Informatë për mediet  
16.08.2011, f. Slloeshticë

### EKSKLUZIVISHT NË SLLOESHTICË

**Gruaja e parë skulptor nga Tunizia - Nazhet Gerisi (Najet Gherissi), mysafir në punëtorinë artistike e ART POINT - GUMNO**



Informatë për KOLIBRI  
24.08.2011, f. Slloeshticë

### FËMIJËT DHE ARTI PËR NATYRËN

**Fëmijët nga Slloeshtica dhe mysafirja nga punëtorja artistike e ART POINT – GUMNO nga Tunizia, Nazhet Gerisi (Najet Gherissi) ndihmojnë “Bella Reka” të mbrojtë peshqit**

Skulptorja nga Tunizia ka qëndruar në Slloeshtinë prej 13 deri 31 gusht në ftesë të Qendrës Ndërkombëtare Artistike ART POINT - GUMNO.

Ndonëse ka ndodhi të ndryshme në shtetin e saj, në të cilin aktivisht zhvillohet lëvizja revolucionare për ndryshimin e regjimit diktatorial, Nazhet Gerisi ka arritur të ndajë pak kohë për vizitë të Maqedonisë, ku do të tentojë të prezantojë magjinë blu nga Kartagina.

Gjërat e vjetra metalike që janë lënë nda avancimi i teknologjisë, prej kur të dalë nga përdorimi, vetëm kanë filluar të funksionojnë në imagjinatën e artistet, e cila në mënyrë intensive ka punuar në skulpturat që do të ekspozohen në mes të fshatit gjatë jubileut të “FESTIMI I PIREUT” më 28 gusht.

Gerisi është inspiruar edhe nga guri i formuar nga lumi i shpejtë “Bella Reka”.

Metali është medie e preferuar e Nazhetit që ka të vendosura skulptura të mëdha në gjithë Tunizinë. Aspekti ekspresiv i skulpturave është theksuar edhe me ngjyrën blu të Mesdheut – shenja mbrojtëse e autores.

Ekspozita e saj momentale udhëtuese në Francë me titullin “Blu Ultramarine” për momentin është e vendosur në Marsej.

Nazhet Gerisi, njëherë gruaja e parë skulptor nga Tunizia, ka qëndruar në Slloeshticë dhe ka krijuar nën inspirimin e bukurive të fshatit Slloeshticë që gjendet në rajonin e epërm të Demir Hisarit, pranë malin Pllaken, përplot me florë dhe faunë.

E mahnitur nga bukuritë natyrore dhe fryma e banorëve lokal, Nazhet u shqetësua nga pamja e pamëshirshme pranë dhe në lumin, uji i të cilit ftoh Sllojçani dhe ujitin fushat që janë të njohura me grohën, patatet, misrin dhe shumë tjera.

**Shënim” Për mos të ndotur foto-lajmin, me qëllim nuk kemi përfshirë pamjet nga mbeturina e hedhura rreth dhe në lumin!**

Në këtë mënyrë u lind ideja për projektin me titull “MIQ TË NATYRËS” të cilin fëmijët menjëherë e pranuan.

E mërkurë – me fat” takimi krijues filloi saktë





në mesditë me hyrje të shkurtë në artin, më saktë në fushën e skulpturës. Nazheti kryesisht punon me metal, por edhe me gurë dhe dru. Në fshatin, ajo është posaçërisht e mahnitur nga guri që ka marrë formën nga ujërat e shpejta të lumit "Bella Reka"

Skulptura shikohet me sy të hapur gjerë por për të hyrë në shpirtin e saj, e prekim me sy të mbyllur!


Gjërata e vjetra metalike, që janë lënë nga avancimi i teknologjisë, dhe nuk përdoren më gjatë kohë, këtu në zyrat e qendrës artistike ART POINT – GUMNO, funksionojnë shkëlqyeshëm, të transformuar në krijesa të reja.

Realizimi i projektit filloi me bisedë



për ne dhe roli ynë në mirëmbajtjen e mjedisit jetësor. Një pllakë hiri metalike që simbolizon lumin, duhet të gjallërohet me ndihmën e fëmijëve, ndërsa peshqit që ikin, të kthehen dhe të plotësojnë ujin me llojllojshmëri, që tani është ende më e ndotur nga mbeturinat që gjenden përreth dhe në lumin!

Punohet me ngjyra akril që nuk janë helmuese për fëmijët dhe lehtë lahen nga duart (si dhe nga rrobat) pas përdorimit ndërsa mbesin përgjithmonë në veprën artistike.



11 fëmijët që një pjesë ishin banorë të fshatit Sillojshticë (siç e quajnë këtu fshatin) dhe një pjesë që kanë ardhur për vizitë tek gjyshërit nga Shkupi dhe Manastiri, kanë punuar në grupe nga tre.

Ka pasur vend që secili të ngjyros 2-3 peshq! Fëmijët thjeshtë kënaqeshin në punën që ishte përfunduar me tortë ditëlindje për nder të Janas që pikërisht atë ditë kishte mbushur 8 vite.

Nazheti e "mbushi" lumin e peshqve me ujë të pastër!

Projekti, si mesazh për të gjithë, ishte ekspozuar në mes të fshatit gjatë jubileut "FESTIMI I PIREUT" që ishte mbajtur më 28 gusht, në ditën e Shën Mërisë, mbrojtëses së fshatit!



**5 ГОДИНИ СЛАВЕЊЕ НА ПИРЕЈОТ**  
с. СЛОЕШТИЦА, 27-28 АВГУСТ 2011



## PROMOVIM TË FONDACIONIT TË SAPOFORMUAR PREDА PLUS

Fondacioni për Zhvillim të Qëndrueshëm Ekonomik PREDА PLUS në bashkëpunim me Agjencinë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe Byronë për Zhvillim të Barabartë Rajonal më 07.04.2011 në Klubin e Gazetarëve, Shkup ka organizuar promovim të fondacionit të sapoformuar PREDА PLUS dhe Prezantim të Thirrjes për Shprehje Interesi për Qendrat Zhvillimore të Rajoneve Planifikuese në Republikën e Maqedonisë, në kuadër të projektit “Zhvillim në Vepër”.

Gjatë evenimentit u zhvillua firmosja e Memorandumit për Mirëkuptim mes PREDА Plus Fondacionit dhe Byrosë për Zhvillim të Barabartë Rajonal në sajë të së cilës do të zbatohet aktivitetet për Ndhimë Teknike e Qendrave për Zhvillim Rajonal



në Republikën e Maqedonisë.

Në kuadër të këtij eventi, ishte bërë prezantim i Thirrjes për Shprehje Interesi për Qendrat për Zhvillim të Rajoneve Planifikuese në Republikën e Maqedonisë, në sajë të projektit “Zhvillim në Vepër”. Kjo thirrje ka për qëllim të sigurojë ndihmë teknike dhe përfundim institucional të dy Qendrave për Zhvillim të Rajoneve Planifikuese në Republikën e Maqedonisë. Si rezultat i aspiratave për afrim drejt Bashkimit Evropian ishte ngritur vetëdija e institucioneve përkatëse për rëndësinë e planifikimit të zhvillimit rajonal, si parakusht për uljen e dallimeve mes rajoneve dhe njëherë do të mundësonte plotësim më të shpejtë të kriterëve ekonomike për hyrje në BE.

Fondacioni për Zhvillim të Qëndrueshëm Ekonomik PREDА PLUS është subjekt i sapoformuar juridik që ka për vizion promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe prosperitetit shoqëror me anë të mbështetjes së nismave publike, private dhe qytetare në nivelin lokal/rajonal në Republikën e Maqedonisë dhe në Ballkan. Ndonëse bëhet fjalë për një institucion të ri, ekipi i PREDА PLUS

pronarëve nga qyteti jonë dhe qytetit të Prizrenit nga Kosova.

Në kuadër të Biznes Forumit ishte firmo-



### Aktivite të PREDА PLUS

Fondacioni për Zhvillim të Qëndrueshëm Ekonomik

Aleksandar Makedonski 32a

P. Fax 246

7500 Prilep

T.: +389 (0) 48 401 581

F.: +389 (0) 48 401 581

www.predaplus.mk

përbëhet nga profesionistë me përvojë të gjatë në fushat e zhvillimit lokal ekonomik, zhvillimit rajonal, mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, hartimi i dokumenteve planifikuese, përgatitje profesional dhe zbatim të projekteve, ndërtim të infrastrukturës,



analizë të zinxhirëve të vlerave, analiza sektoriale etj.

Realizimi i projektit “Zhvillim në Vepër” financiarisht është mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (SDC) e përfaqësuar nga Zyra për Bashkëpunim pranë Ambasadës Zvicerane në Republikën e Maqedonisë.

## BIZNES FORUM I PRONARËVE NGA PRILEPI DHE PRIZRENI, KOSOVË

Në organizim të Agjencisë Rajonale të Jug Kosovë, Fondacioni për Zhvillim të Qëndrueshëm Ekonomik PREDА Plus dhe Oda Ekonomike Rajonale nga Prilepi më 29.04.2011 (të premtën) në hotelin “Salida” ishte mbajtur biznes forum mes

sur Memorandum për Bashkëpunim mes PREDА Plus dhe Agjencisë Rajonale Zhvillimore Jug nga Kosova.

Në biznes delegacionin nga Prizreni ishin prezent përfaqësues të shumë kompanive që ishin të interesuara për bashkëpunim në fushat vijuese ekonomike:

- Tregti me produkte bujqësore.
- Tregti me duhan dhe produkte duhani.
- Përpunim dhe tregti me mermer.
- Tregti me tekstil dhe konfeksion.
- Tregti me këpucë dhe
- Shërbime.



## AKTIVITETE TË QENDRËS PËR ZHVILLIM LOKAL – GJEVGJELI

Fondacioni për Zhvillim Lokal dhe Zhvillim të Teknologjisë Informatike nga Gjevgjelja duke filluar prej muajit qershor 2011 në periudhë prej një viti do të realizojë projektin “Bashkëpunimi Ndërkufitar në Fushën e Burimeve të Energjisë dhe Efikasitetit Energjetik” në partneritet me “Aleancën e Prodhuësve të Energjisë Ekologjike” nga Bllagoevgrad, R. e Bullgarisë.

Projekti është aprovuar në kuadër të IPA programit për bashkëpunim ndërkufitar. Projekti ka për qëllim të krijojë kushte për zhvillim të qëndrueshëm dhe

llojlojshmëri në ekonominë e rajonit të përbashkët ndërkufitar të Bullgarisë dhe Maqedonisë me nxitjen e sipërmarrjes dhe investimeve në fushën e përdorimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë (BRE). Zbatimi i projektit ka për qëllim të sigurojë mundësi të reja për zhvillimin e rajonit ndërkufitar duke shfrytëzuar potencialin e pasur në fushën e energjisë alternative dhe efikasitetit energjetik dhe në kohën e njëjtë të sigurojë mbrojtje të rrethinës lokale dhe llojlojshmërisë biologjike.

Me qëllim të arritjes së objektivit të përgjithshëm, zbatohet një plan i sërë aktivitetesh të orientuara drejt arritjes së qëllimeve specifike të projektuara të projektit me detajet më poshtë:

- Të promovohet shkëmbimi ndërkufitar dhe lidhja në rrjet i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe shoqatave afariste që janë aktive në fushën e energjisë alternative dhe efikasitetit energjetik;
- Të përmirësohet qasja e informata dhe këshillave në fushën e BRE dhe EE në rajonin ndërkufitar;

### Aktivitete të QENDRËS PËR ZHVILLIM LOKAL – GJEVGJELI

- Të ndikohet mbi vetëdijen dhe njohurinë e të rinjve për përdorimin racional dhe përfitimet nga BRE;

- Të rritet shkëmbimi ndërkufitar i njohurive, eksperiencave dhe praktikave të mira mes Bullgarisë dhe Maqedonisë për përmirësimin e kapacitetit dhe promovimin e prezantimit të BRE;
- Të ngrihet vetëdija e komuniteteve synuese ndërkufitare për potencialin dhe mundësitë për prodhimtari dhe përdorim të energjisë në BRE të ndryshme në rajonin ndërkufitar.

## 2. PREZANTIMI I RRJETIT PËR ZHVILLIM RURAL NGA SUEIDIA

### LËVIZJA AKSION FSHATI SUEDEZ “Hela Sverige ska leva” (Gjithë Suedia do të jetojë)

Lëvizja suedeze aksionare përbëhet nga rreth 4 700 grupe aksioni fshatare ndërsa numri i tyre vazhdimisht rritet. Vlerësimi i përafërt është se 100 000 individë janë drejtpërdrejtë të përfshirë në grupet e tilla aksioni fshatare dhe që puna e tyre drejtpërdrejtë ndikon mbi tre milion njerëz – një e treta e popullatës së përgjithshme të Suedisë.

Këto grupe aksioni mund të gjenden në gjithë Suedinë dhe merren me gjitha aktivitetet. Ata kanë shitore, organizojnë kujdesie të fëmijëve, ndërtojnë qendresa për energji elektrike të fituar nga era dhe riparojnë rrugët.

Shpeshherë puna e tyre fillon me krizë lokale, për shembull kur ndonjë fabrikë ndalet me punë ose mbyllet ndonjë shkollë. Fshatarët shikojnë nevojën për veprimtari kolektive. Zakonisht disa persona të dedikuar janë udhëheqës të aksionit. Në suedisht ata i quajnë “shpirtra të zjarrtë” – ndërsa të tjerët i ndjekin.

#### HISTORIKU

Hela Sverige ska leva është themeluar në vitin 1989 si rezultat i fushatës që udhëhiqeshe me moton “Gjithë Suedia do të jetojë”.

Popullata nga rajonet rurale të Suedisë kanë përcaktuar detyrat e kësaj fushate. Shpeshherë viset e banuara në rajonet veriore nga brendësia janë ballafaquar me programin e papunësisë dhe mungesës së shërbimeve hoteliere. Një grup i madh i të rinjve janë shpërngulur ndërsa fshatarët ishin ndjerë si të braktisur nga pushteti.

Qëllimi i fushatës ka qenë të mobilizojë popullatën nga rrethinat rurale dhe të ndryshojë qëndrimin e opinionit më të gjerë si dhe vendimmarrësve. Qëllimi më i fundit, por njësoj i rëndësishëm do të ishte përmirësimi i politikës kombëtare rurale.

Fushata ka qenë shumë sukses. në gjithë shtetin ishin dërguar letra përplot me propozime dhe ide dhe kërkesa



të individëve ndërsa organizata të ndryshme kanë shprehur kritika ndaj qeverisë. Kur letra zyrtare ishte dorëzuar politikanëve, ka përmbajtur rreth 6 000 propozime dhe kërkesa të cilat ishin lidhur me problemet rurale!

Në fund të fushatës janë formuar rreth 1 000 grupe aksioni fshatare. Kjo ishte struktura më e madhe e kapacitetit enorm që popullata rurale mund të ketë. "Për secilin fshat, ka shpresë vetëm nëse njerëzve ju mundësohet shans për veprim"

### Organizimi

"Hela Sverige ska leva"(Gjithë Suedia do të jetojë) është shoqatë nacionale e cila përbëhet nga 4 700 grupeve aksioni fshatare të përmendura më lartë dhe 40 organizata anëtare të cilat janë kryesisht organizata joqeveritare. Ekzistojnë 24 rrjete fshatare që punojnë me servis

informatash dhe këshilla në nivel të rajoneve. Këto organe këshillimore rajonale i formojnë grupet lokale aksioni nga rajoni. Bordi i cili përbëhet nga përfaqësues të grupeve lokal dhe organizatave anëtare është përgjegjës për aktivitetet rrjedhore. Një sekretariat i vogël që gjendet në Stokholm kujdeset për kontaktet, administrimin dhe informatat.

### Detyrat

Misioni i Hela Sverige ska leva është të mbështet zhvillimin lokal në drejtim të shoqërisë së qëndrueshme. "Neve stimulojmë bashkëpunim, këshillojmë dhe mbështesim grupe lokale dhe i furnizojmë me vegla që do të ndihmojnë të korrin sukses në punën me zhvillimin lokal. Gjithashtu, kemi për qëllim të ndikojmë mbi opinionin publik dhe politikën rurale të qeverisë – që të mund

gjithë Suedia të jetojë!"

Hela Sverige ska leva ka edhe bashkëpunim ndërkombëtar, e cila është një prej forcave shtytëse e Hela Norden ska leva (I gjithë Veriu do të jetojë) si dhe pjesë e Lëvizjes Aksione të Evropës ndërsa bashkëpunojnë edhe me rrjete evropiane rurale.

### Parlamenti rural

Gjatë çdo viti të tyre organizohet Parlamenti Rural – eveniment që grumbullon 1 000 persona nga Suedia dhe shtetet tjera. Gjatë disa ditëve ata takohen dhe diskutojnë për tema të rëndësishme rurale. Parlamenti Rural gjithashtu ka për qëllim të tërheq vëmendjen publike drejt Suedisë rurale. Parlamenti Rural vijues do të mbahet në Ronbi, Blekinge më 7 dhe 8 shtator 2012.

## 3. AKTIVITETE TË RËNDËSISHME TË RZR TË RM-SË PËR VITIN 2011

### Aktivite të RZR i RM-së në vitin 2011



Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë programin e saj për vitin 2011 e zbaton duke përdorur eksperiencën e fituar paraprakisht me përgatitjen e strategjive komunale për zhvillim rural nga Programi për Mbështetjen e Shërbimeve Këshillimore në Bujqësi MAASP (2004-2010). Mbështetja e tillë e komunave në procesin e përpilimit të strategjive për zhvillim rural vazhdon edhe në vitin 2011. Programi mbështetet në dy qëllime strategjike, si:

1. Ngritja e kapaciteteve në gjitha tre sektorët (publik, shoqëror dhe afarist) në nivelin lokal në Grupe Lokale Aksioni (GLA) dhe zhvillimin e LEADER me anë të qasjeve të bazuara në

fushën dhe zhvillimin e strategjive lokale për zhvillim rural;

2. Ngritja e kapaciteteve të anëtarëve për mbështetjen e grave në rajonet rurale;

Realizimi i aktiviteve për arritjen e qëllimit të parë strategjik zhvillohet në pesë komuna të përzgjedhura: Shtip, Koçan, Vinicë, Centar Zhupa dhe Dollneni.

Në secilën prej komunave ishin

themeluar grupe lokale joformale për zhvillim rural (GLZR). Duke u udhëhequr me parimin e mbisundimit të mirë, për vendosjen e bashkëpunimit mes vetëqeverisjes lokale, sektorit qytetar dhe afarist, për nevoja të interesit të përbashkët, secila GLZR ishte formuar nga anëtarë, përfaqësues të tre sektorëve të përmendur.

Metodologjia e përgatitur ka siguruar transferim të eksperiencës dhe njohurisë gjatë themelimit të GLZR-ve (para se të themelohen GLA-të zyrtare në të ardhmen) si dhe zhvillim të strategjive lokale për zhvillim rural. Përveç kësaj, pas përgatitjes së strategjisë, secili grup ishte udhëzuar të përgatitnin dhe zbatonin projekt nga strategjia lokale me qëllim që në praktikë të mësojnë metodologjinë e "Udhëheqjes me cikël projektues". Paralelisht me këtë proces, ishte zbatuar një trajnim për planifikim strategjik si dhe zhvillim të shkathësive për përdorim të veglave për pjesëmarrje në komunitetin. Në fund, strategjitë e



përgatitura ishin revizuar nga ana e një mentori (trajnesi). Me qëllim që strategjitë të bëhen dokumente zyrtare të komunave, GLZR kanë dorëzuar materialet para Këshillave të Komunave për miratim.

Për realizim të qëllimit të dytë strategjik, RZR ka vazhduar me procesin e angazhimit të anëtarëve të rinj të organizatave të grave nga mjediset rurale, për t'i inkurajuar të përfshihen në lëvizjen rurale në RM me mbështetjen e RZR-së. Ky proces zbatohet me anë të organizimit të takimeve direkte me gratë nga mjediset rurale dhe organizatat e tyre dhe prezantimi i praktikave të mira nga eksperiencat e vendit dhe të huaja si dhe zbatimin e trajnimeve përkatëse për ngritjen e kapaciteteve të tyre. Në këtë drejtim, RZR-ja mbështet anëtarë të organizatave të grave duke përdorur transferimin e teknologjive dhe shkathtësive për përgatitjen e produkteve tradicionale. Ekspertiza që përdoret është praktikë e mirë por gjithashtu edhe organizata artizanale të grave që janë anëtare të RZR-së.



## 4. ARDHMËRIA E LEADER

### Ardhmëria e "LEADER" – Analiza e Robert Lukeshq

Prej 27 deri 29 prill në Bad Shandau (Shasen, Gjermani) ishte mbajtur konferenca e dytë e LINC (Leader Inspired Network Community). Në këtë eveniment të rëndësishëm që ishte dedikuar bashkëpunimit dhe lidhjes në rrjet, ishin prezent përfaqësues të Grupeve Lokale Aksioni (GLA), pjesëmarrës në zhvillimin rural si dhe për herën e parë, përfaqësues të Rrjetit Evropian për Zhvillim Rural dhe Komisioni Evropian.

Anëtar i ARC Core Group, Robert Lukeshiq (Qendra Rajonale Konsultimi, Austri) ka marrë pjesë në konferencën dhe ka bërë një përmbledhje të ideve kryesore dhe planeve të Komisionit Evropian të lidhura me ardhmërinë e LEADER programin.

Pritet që Komisioni të sjell një propozim të rëndësishëm në gusht 2011 bashkë me propozimet tjera "ZZP" për vitin 2013. Në kuadër të këtyre planeve pritet që LEADER të bëhet instrumenti kryesor për zhvillim në nivelin nën-rajonal ndërsa Komisioni planifikon që këtij zhvillimi nën-rajonal të jep status prioritar.

Planet e Komisionit për periudhën vijuese programore 2014 – 2020 do të përfshijnë propozimet kryesore më poshtë:

- Kornizë të ndarë strategjike dhe menaxhim me fondet e Komisionit nga BE-ja, si dhe norma për zhvillimin nën-rajonal dhe bashkëpunim në nivelin lokal;
- Më tepër, por jo shumë të rrepta, udhëzime të shteteve anëtare të BE-së për zbatim efektiv të LEADER programit. Shtetet anëtare do të mund të zgjedhin shembuj të volitshëm rajonal të LEADER programit. Për secilin grup lokal aksioni do të ketë një fond kryesor (mund të ketë katër fonde të tilla ESF, ERDF, EFF dhe EAFRD). Baza financiare do të zgjerohet;
- Kërkesë nga grupet lokale aksioni dhe zbatues të programit për kuptim më të mirë të tetë specifikave të LEADER programit (vendimarrje e decentralizuar, qasja rajonale, qasja nga poshtë-lartë, qasja partneri me grupet lokale, inovacione, integritime shumë-sektoriale, lidhja në rrjete si dhe bashkëpunimi ndërkombëtar) në strategjitë për zhvillim lokal dhe në mënyrën e punës së partneriteteve lokale;
- Fleksibilitet më të madh dhe orientim drejt inovacioneve dhe udhëheqjes lokale. Strategjitë për zhvillim lokal do të jenë "vegla" kryesore për realizimin e këtyre qëllimeve në nivelin nën-rajonal;
- Liri më të madhe të veprimtarisë së grupeve lokale aksioni. Kjo duhet të sigurohet me anë të ndarjes së qartë të detyrave mes pushtetit drejtues dhe GLA me angazhim më të madh të formave të ndryshme të bashkimit mes partnerëve shtetëror dhe privat;
- Më tepër mjete për animim dhe krijim të kapaciteteve (si dhe për përpilimin e strategjive për zhvillim rural (në periudhën testuese);
- Përforsim të bashkëpunimit ndërkombëtar në gjithë Evropën me anë të përforsimit të mjeteve për lidhjen e rrjeteve edhe atë në nivel të anëtarëve të BE-së;
- Përforsim i lidhjeve mes rajoneve urbane dhe rurale.

Komisioni nuk shpreson që gjitha komponentët nga planet e tyre ambicioze të janë të mbështetura me njëzëri nga shtetet anëtare dhe prandaj kërkon mbështetjen e madhe nga rrjeti për zhvillim rural dhe udhëheqësit e LEADER programit të cilët duhet të sjellim propozimet nëpërmjet negociatave të procesit aktual për formulimin e ligjeve.



## 5. LEADER NË EVROPË

Eksperienca me LEADER qasjen në shtetet anëtare në BE ka treguar që është një metodë efektive për realizimin e qasjes së nevojshme të përbashkët. Ajo mbështet projekte, të cilat përfshijnë më tepër se një aspekte të zhvillimit rural, që më tepër programe tjera me qëllime të caktuara, ndonjëherë e bëjnë. LEADER ju ka mundësia komuniteteve rurale të sjellin vendime kryesore për prioritetet dhe nevojat në fushat e tyre dhe të sigurojë financim dhe kapacitete për të ndihmuar gjatë realizimit të zgjidhjeve. Ajo ka ndihmuar në zgjerimin e kapaciteteve të organizatave lokale për mbështetjen e aksioneve lokale për zhvillim rural. Gjithashtu, mund të inkurajojë regjenerim në fushat që zakonisht nuk do të përfshiheshin nga burimet tjera të financimit, por ku ka nevojë të dëshmuar. Përveç kësaj, mund

të jep fuqi aktorëve lokal të shikojnë më tutje nga projekti i tyre dhe të shqyrtojnë ndikimin e tyre jashtë përfituesve direkt. Eksperienat dhe leksionet nga LEADER në shtetet anëtare të BE-së kanë shërbyer për krijimin e kornizave për rekomandimet më poshtë që do të zbatohen në të ardhmen:

- LEADER metoda duhet të mbështet projekte/qëllime ekologjike, ekonomike dhe shoqërore;
- Realizimi duhet të zhvillohet nëpërmjet Grupeve Lokale Aksioni. Zgjedhja e Grupeve Lokale Aksioni (GLA) duhet të ketë parasysh pavarësinë e ndërsjellë të çështjeve ekonomike, shoqërore dhe ekologjike në kontekst të zhvillimit të qëndrueshëm rural dhe vlerësim përkatës të nevojave;
- LEADER aksionet duhet të plotësojnë iniciativat tjera, përfshirë edhe

programet relevante urbane. Rrjetëzimi ka rol të rëndësishëm në sigurimin e plotësimit, si dhe në shkëmbimin e eksperiencave pozitive. Bashkëpunimi ndër-rajonal dhe ndërkombëtar mund të jetë edhe një mënyrë e rëndësishme e shkëmbimit të eksperiencave dhe aftësive ndërsa nga ana tjetër ngiten kapacitetet e komuniteteve;

- Grupet Lokale Aksioni duhet të kenë kontribut të rëndësishëm nga organizatat vullnetare dhe individët ndikues në komunitetin. Qëllimet e tyre ekonomike, shoqërore dhe ekologjike duhet të jenë të pasqyruar në anëtarësinë e tyre;
- LEADER duhet të zbatohet nga organ që ka mandat për të mbështetur aksione që kanë për qëllim zhvillimin e qëndrueshëm;

## Përralla të suksesshme (Spanjë, Itali dhe Francë) LEADER rajonal + Programi Lombardi – Itali

Emri i projektit: **TA KSI BUS, pjesë e krijimit të rrjetit të transportit të integruar rural**

Projekti "Taksibus" zhvilluar në kuadër të aksionit "Krijimi i rrjetit të transportit të integruar rural" është koncentruar në plotësimin e shpejtë të nevojave të banorëve lokal. "Taksibus" është pilot projekt, bazuar në fazën e parë dhe vetëm në një pjesë të LEADER+ fushën për komunat që janë në lartësi të madhe mbidetare dhe janë më të largët: Brallo di Pregola, Menconico, Varzi dhe Santa Margherita Staffora. Nevojat më të rëndësishme të banorëve janë: shoqërore (blerje, evenimente fetar edhe kulturore, shërbime poste dhe financiare), sport (posaçërisht për të rinjtë) dhe shëndet (spital, farmaci dhe mjek). Duke marrë parasysh që 48,5% të popullatës jetojnë në fshatra të izoluar dhe shumë prej shërbimeve gjenden në qytetet kryesore ose diku më larg rajonit të LEADER+, transporti është nevoja e parë e domosdoshme.

GLA Alto Oltrepò, Comunità Montana Oltrepo Pavese dhe provinca Pavia kanë organizuar shumë grupe pune për të gjetur përgjigje nevojave të banorëve lokal dhe të japin mundësi për qasje më të lehtë të shërbimeve (tregje, postë, banka, spital, farmaci...).

### Projekti përbëhet nga:

- krijimi i modelit inovative dhe efikas që do të tejkalojë transportin klasik publik;
- organizimi i rrjedhave për transport lokal për të administruar lëvizjen lokale me vëmendje të posaçme për: shkollat, tregjet, spitalet, vendet religjioze, qendrat shoqërore, kulturore dhe sportive; shërbimi është organizuar sipas destinacionit dhe bazohet në sistem të caktimit të drejtpërdrejtë;
- realizimi i studimeve për administrim për të përcaktuar mënyrat, përdoruesit dhe nevojat;



- pilotimi i shërbimit;
- organizimi i qendrës për caktim;
- vendosja e planit komunikues për promovim të shërbimit;
- promovimi i rrjetit.

### Realizimi dhe rezultatet nga projekti

Për realizim të pilot projektit është





përgjegjëse Comunità Montana Oltrepo Pavese. Gjatë kohës së pilotimit u paraqitën dy aksione me të cilat udhëheq në mënyrë të ndryshme: aksioni transport “sipas kërkesës” – Taksibus (në thirrje) kryen shërbime transportimi, ndërsa me aksionin “Transport tematik” udhëheq Comunità Montana Oltrepo Pavese.

**Aktivitetet në kuadër të transport “me kërkesë” – Taksibus përfshijnë:**

- përcaktimi i pilot rrjetit të transportit të integruar rural;
- promovimi dhe informimi për shërbimin në fushatë përkatëse;
- sigurimi i shërbimit;
- bashkëpunimi me pushtetin lokal dhe Comunità Montana Oltrepo Pavese për realizimin e projektit dhe planifikimi i aktiviteteve vijuese.



**Aktivitetet për “transport tematik” janë lidhur me:**

- promovimi i shërbimeve që nuk mund të merren,
- ndjekja e nevojave të banorëve,
- vlerësim i propozimeve të dhëna,
- zgjedhje të propozimeve më të mira për transport me grumbullim të përdoruesve sipas temës përkatëse (treg, postë, sport, kulturë...),
- dhënia e shërbimeve;
- revizion dhe ndjekje të shërbimeve.

## LEADER+ programi rajonal në Kataloni – Spanjë

Titulli i projektit: **Qendër kopshtare për integrim të personave me pengesa**



Fondacioni për Mbrojtjen dhe Ndihmën e Personave me Pengesa (FMNPP) ka për qëllim të sigurojë ndihmë dhe mbështetje personave me pengesa dhe familjeve të tyre. Fondacioni është organizatë joprotabile e profesionistëve, e mbështetur nga anëtarë të familjeve të njohura nga rajoni. Ky është institucioni i vetëm i territorit të GLA-së që kryen operacioni të orientuara për plotësimin e nevojave të personave me pengesa. Qëllimi i Fondacionit është krijimi,

zbatimi dhe administrimi me gjitha llojet e aktiviteteve që mund të jenë në dobi të personave me të meta fizike, mentale dhe ose motorike, që synojnë përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre dhe lehtësimin e integritetit të tyre në strukturat shoqërore si qytetarë aktiv lokal.

Sot, fondacioni ka qendër për zhvillimin e fëmijëve, kapacitet rezidencial për sigurim të ndihmës mjekësore, dy shtëpi për qëndrim dhe sërë shtëpish për kujdesen që plotësojnë nevoja specifike për akomodim dhe ofron këshilla profesionale terapeutike dhe programe konkrete me aktivitete çlodhëse dhe të orientuara.

Në kuadër të fondacionit, ishin themeluar edhe një Qendër për Punësim e veçantë për të ofruar punë personave me pengesa që nuk mund të integrohen në ndërmarrjet normale, mundësi për punë me pagesë që është në pajtim me kapacitetet e tyre.



**Projekti përbëheshe nga:**

Sigurimi i shërbimeve kopshtare që ndihmojnë për integrim shoqëror të personave me pengesa. Fondacioni ka punuar nën marrëveshje me pushtetin lokal, kompani dhe individë. Suksesi i këtij aktiviteti solli llojllojshmëri të paletës së shërbimeve të ofruara: ata përfshijnë mirëmbajtje të hapësirave publike, punë pyjore, mirëmbajtje të buzëve të lumenjve, et. Për realizimin e shërbimeve kopshtare ishte ndërtuar një kapacitet në të cilën ishte vendosur punësoria (për magazinim, mirëmbajtje dhe mbrojtje të pajisjeve të ndryshme më të re, në pajtim me standardet e sigurisë), bashkë me hapësira për trajnim dhe zyrë për planifikim dhe udhëheqje me



operacionet. Ekziston edhe hapësirë për pranimin e vizitorëve dhe klientëve potencial.

Ishin krijuar 10 vende pune për personat lokal me pengesa, bashkë me tre vende tjera për staf ndihmës (instruktorë dhe vëzhgues).

Kjo është në pajtim me një prej qëllimeve kryesore të GLA, d.m.th. krijimi i vendeve lokale të punës për popullatën e gjerë.

Projekti i kopshtarisë i organizuar nga fondacioni ofron punësim të vazhdueshëm për personat me pengesa në formë të punës që drejtpërdrejtë do të kontribuojë për ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit jetësor në rajoni lokal si dhe përmirësimin e cilësisë së jetës.



### **Realizmi dhe rezultate nga projekti**

Përfshirja e organeve siç janë pushtetet komunale të Ripol dhe provincës të pavarur Katalonia ishte kryesore për suksesin e projektit. Pushtetet komunale të Ripol kanë siguruar tokën për ndërtimin e punëtorisë së re, e cila ishte e nevojshme për të plotësuar nevojat e klientëve, për të siguruar trajnim për personat me pengesa dhe garantim të standardeve për cilësi dhe siguri dhe

tejkalimin e tyre. Provinca Katalonia dhe dy fondacione kanë siguruar mjete financiare për ndërtimin dhe zhvillimin e punëtorisë si dhe furnizim i veglave dhe pajisjeve më të reja të kopshtarisë.

Ajo ka mundur punësimin e 10 personave tjerë me pengesa për punë në projektin, bashkë me tre vëzhgues për trajnim të stafit dhe udhëheqje me punës. Pamjet për përmirësim funksionale të strukturës së re dhe firmosja e marrëveshjeve të reja janë ashtu që në afat të shkurtë ose mesëm, mund të parashikohet integrimi i personave tjerë me pengesa fizike, mentale ose motorike ose persona që gjenden në situatë të vështirë sociale.



## **RRJETI PËR ZHVILLIM RURAL I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË**

Rr. "Orce Nikolov" br. 188-1/8

1000 Skopje, R. Makedonija

petar.g@ruralnet.mk

vesela.ld@ruralnet.mk

++389 70 343528

++389 07 343513

[www.ruralnet.mk](http://www.ruralnet.mk)

